



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

MBI

RREGULLA TË MËTEJSHME PËR INVESTIMET DHE VEPRIMTARINË
E FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT

Miratuar me Vendim Bordi nr. 154, datë 19.09.2024

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

1. Përcaktimi i rregullave të mëtejshme për investimet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të aktiveve të fondit të pensionit privat të miratuar në Republikën e Shqipërisë.
2. Përcaktimi i kërkesave për veprimtarinë e fondit të pensionit privat që duhet të zbatohen nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët e licencuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe nga subjektet të cilave shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët i kanë deleguar aktivitetet përgjegjëse.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe të nenit 89, pika 6, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Neni 3

Përkufizimet

Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, referuar në këtë rregullore shkurt “Ligji” si dhe të Ligjit “Për tregjet e kapitalit”. Për qëllime të kësaj rregulloreje me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. **“Rreziku i likuiditetit”** është rreziku i humbjes kur një pozicion aktiv i portofolit të fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një kohe mjaftueshmërisht të shkurtër, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për pagesat e pensionit, tërheqjet e parakohshme dhe transferimet e aktiveve të anëtarit në një fond tjetër pensioni, të përcaktuara në prospektin e fondit të pensionit privat.
2. **“Rreziku i Tregut”** është rreziku që lind nga luhajtjet në vlerën e tregut të pozicioneve në portofolin e fondeve që lidhen me ndryshimet në variabla të tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave.
3. **“Titull bazë”** (*Underlying security*), është termi që përdoret në tregtimin e derivateve, për të treguar aktivin apo titullin në të cilin bazohet derivati. Aktiv i apo detyrimi është instrumenti financiar bazë, i tillë si një aksion, mall, monedhë, indeks, kontratë standarde të së ardhmes (futures), në çmimin e të cilit bazohet çmimi i derivatit.
4. **Transaksion “Arms Length”** është transaksioni ku blerësi dhe shitësi i instrumentit financiar veprojnë në mënyrë të pavarur dhe në interesin më të mirë vetjak, ashtu siç do kishin vepruar nëse do të bënin transaksion me një palë tjetër jo të lidhur, të kryer në përputhje me kushtet normale të tregut, ku nuk ka asnjë favorizim të padrejtë të fituar nga njëra palë në përfitim të palës tjetër.

KREU II
TRANSAKSIONET QË KRYHEN NGA SHOQËRIA ADMINISTRUESE PËR FONDIN
E PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR DHE PJESËMARRJE TË
MBYLLUR

SEKSIONI 1
PËRKUFIZIMI DHE PRAKTIKA E EKZEKUTIMIT MË TË MIRË

Neni 4

Detyrimi për të vepruar në interesin më të mirë të fondit të pensionit privat

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat gjatë ekzekutimit të vendimeve për tregtimin e instrumenteve financiare në emër dhe për llogarit të fondit të pensionit privat, duhet të veprojë në interesin më të mirë të secilit fond pensioni privat që administron.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat gjatë ekzekutimit të vendimeve për tregtimin e instrumenteve financiarë, duhet të marrë të gjitha hapat e mjaftueshëm, për të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm për secilin fond pensioni privat që administron, duke marrë parasysh:
 - a) Çmimin;
 - b) Kostot;
 - c) Shpejtësinë;
 - d) Mundësinë e ekzekutimit;
 - e) Mundësinë e shlyerjes;
 - f) Madhësinë dhe natyrën e urdhrit; dhe
 - g) Çdo konsideratë tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit për tregtim;

Këtej e tutje referuar si '*faktorë ekzekutimi*'.

Neni 5

Ekzekutimi më i mirë

1. Kur shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat tregton instrumente financiare për llogari të një fondi pensioni privat që administron, ajo duhet të garantojë ekzekutimin më të mirë.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të marrë të gjitha hapat e mjaftueshëm, gjatë ekzekutimit të urdhrave, për të arritur rezultatet më të mira të mundshme për anëtarët e fondeve të pensionit privat duke marrë parasysh rëndësinë

relative të faktorëve të ekzekutimit sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

3. Autoriteti e konsideron ekzekutimin më të mirë si të përmbushur nëse shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duke vepruar për llogari të fondit të pensionit privat, sigurohet që urdhri është ekzekutuar duke marrë rezultatin më të mirë të mundshëm në treg ose tregje në atë moment, duke mbajtur në konsideratë madhësinë dhe shpejtësinë urdhrin, marzh-in e tregut (*spread*), palët dhe vendet e ekzekutimit të urdhrin.
4. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të krijojë dhe të zbatojë masa efektive si dhe të marrë të gjitha hapat e mjaftueshëm për të përmbushur detyrimin e saj për të arritur rezultatet më të mira të mundshme për fondet e pensionit privat nën administrimin e saj.

Neni 6

Bashkimi dhe shpërndarja e drejtë

1. Nëse urdhrat për transaksione/tregtim në instrumente financiare të shoqërisë administruese të fondeve bashkohen me ato të disa fondeve të pensionit dhe të SIK nëse administrojnë dhe SIK, dhe/ose portofoleve nëse administrojnë portofole individuale, shoqëria administruese e fondeve duhet:
 - a) T'i shpërndajë instrumentet financiare në mënyrë të drejtë ndërmjet fondeve /portofoleve, urdhrat e të cilëve janë bashkuar, në përpjesëtim me vlerën e secilit urdhër;
 - b) Të mbartë pjesën e pa-ekzekutuar të urdhrin të bashkuar në ditën tjetër kur tregtimet janë të mundshme dhe pastaj të aplikohet parimi i përcaktuar në shkronjën a) të kësaj pike.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat nuk duhet të bashkojë një urdhër tregtimi për fondin e pensionit privat nën administrim me urdhrat për tregtim në emër dhe për llogari të vetë shoqërisë administruese, përveç rastit nëse një bashkim i tillë kryhet në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti ose tregu i rregulluar.

Neni 7

Faktorët në vendosjen e ekzekutimit më të mirë

1. Gjatë ekzekutimit të urdhrave për tregtim, shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të marrë parasysh kriteret e mëposhtme në përcaktimin e rëndësisë relative të faktorëve të ekzekutimit:

- a) Objektivat, politikën e investimeve dhe rreziqet specifike të fondit të pensionit privat;
 - b) Karakteristikat e urdhrit për tregtim të instrumentit financiar që është subjekt i atij urdhri;
 - c) Karakteristikat e platformave të ekzekutimit ku do të drejtohet urdhri.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat përmbush detyrimin e saj, sipas këtij neni, duke marrë të gjitha hapat/masat e mjaftueshme/të nevojshme për të dokumentuar arritjen e rezultatit më të mirë të mundshëm për një fond pensioni privat duke e ekzekutuar urdhrin në zbatim të një vendimi specifik si mënyrën më të mirë për të ekzekutuar urdhrin.
 3. Shpejtësia, mundësia e ekzekutimit dhe shlyerjes, madhësia dhe natyra e urdhrit, marzhi i tregut (spread) dhe çdo kosto tjetër e fshehur e transaksionit, mund të kenë përparësi mbi çmimin dhe koston e atij momenti, vetëm nëse ato japin rezultatin më të mirë të mundshëm në lidhje me fondin e pensionit privat.

Neni 8

Dokumentimi i politikave më të mira të ekzekutimit të urdhrave

1. Politika e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat për ekzekutimin e urdhrave duhet të dokumentohet dhe duhet të përcaktojë rëndësinë relative të secilit prej faktorëve të ekzekutimit ose duhet të krijojë një proces sipas të cilit shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat do të përcaktojë rëndësinë relative të faktorëve të ekzekutimit. Rëndësia relative që shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat u jep këtyre faktorëve të ekzekutimit duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm në ekzekutimin e urdhrave të fondeve të pensionit privat.
2. Për qëllime të kryerjes së ekzekutimit më të mirë, kur ekziston më shumë se një vend tregtimi për të ekzekutuar një urdhër për një instrument financiar, duhet të merren parasysh komisionet dhe kostot e transaksionit që i ngarkohen fondit të pensionit privat për ekzekutimin e urdhrit në secilën prej tregjeve apo platformave ku ekzekutohet urdhri, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e rezultateve më të mira të mundshme.
3. Çmimi ka një rëndësi të lartë relative në marrjen e rezultatit më të mirë të mundshëm për një fond pensioni privat. Megjithatë, në disa rrethana, për disa urdhra, për disa instrumente financiare ose tregje, politika e përshtatshme e ekzekutimit të urdhrave mund të përcaktojë faktorë të tjerë të ekzekutimit që janë më të rëndësishëm sesa çmimi në marrjen e rezultatit më të mirë të ekzekutimit.

4. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të jetë në gjendje të vërtetojë se i transmeton dhe ekzekuton urdhrat në përputhje me politikën më të mirë të ekzekutimit.

Neni 9

Informimi i politikave më të mira të ekzekutimit

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat krijon dhe zbaton një politikë të ekzekutimit të urdhrave që të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm në ekzekutimin e urdhrave për tregtim dhe duhet t'ia komunikojë këtë politikë si Autoritetit ashtu edhe anëtarëve.
2. Ky informacion duhet të shpjegojë qartë se si do të ekzekutohen urdhrat nga shoqëria administruese e fondeve për fondin e pensionit privat, duke përfshirë:
 - a) Një listë të tregjeve apo platformave të ekzekutimit në të cilat shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ka besueshmëri në përmbushjen e detyrimit të saj të marrjes të të gjitha hapave të arsyeshëm për të arritur në mënyrë të qëndrueshme rezultatin më të mirë të mundshëm për ekzekutimin e urdhrave për fondin e pensionit privat dhe duke specifikuar se cilat platforma ekzekutimi përdoren;
 - b) Një listë të faktorëve të përdorur për të zgjedhur tregun apo platformën e ekzekutimit, përfshirë faktorët cilësorë, siç janë klerimi dhe shlyerja, veprimet e planifikuara ose edhe ndonjë faktor tjetër të rëndësishëm, si dhe rëndësinë relative të secilit faktor;
 - c) Informacionin rreth faktorëve të përdorur për të zgjedhur tregun apo platformën e ekzekutimit, i cili duhet të jetë në përputhje me kontrollet e përdorura nga shoqëria administruese e fondeve;
 - d) Faktorët e ekzekutimit të çmimit si kosto, shpejtësia, mundësia e ekzekutimit dhe çdo faktor tjetër relevant që konsiderohen si pjesë e të gjitha hapave të mjaftueshëm për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për fondin e pensionit privat;
 - e) Aty ku është e aplikueshme, informacionin se shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ekzekuton urdhrat jashtë një platforme tregtimi, pasojat, për shembull rrezikun e palës tjetër që rrjedh nga ekzekutimi jashtë platformës së tregtimit dhe informacion shtesë për pasojat e këtij mjeti të ekzekutimit me kërkesë të anëtarit.
3. Kur politika e ekzekutimit të urdhrave parashikon mundësinë që urdhrat mund të ekzekutohen jashtë tregut të rregulluar ose platformave shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të informojë anëtarët në lidhje me këtë mundësi përmes publikimit të kësaj politike në faqen e internetit të shoqërisë.

4. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat shqyrton politikën e ekzekutimit të urdhrave sa herë që ndodh një ndryshim thelbësor që ndikon në aftësinë e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm për fondet e pensionit privat nën administrimin e saj.

Neni 10

Ekzekutimi në kohë

1. Kur shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat vendos të ekzekutojë një urdhër për fondin e pensionit privat, ajo e ekzekuton urdhrin sapo të jetë koha e përshtatshme sipas rrethanave për ta kryer këtë veprim.
2. Kryerja e transaksionit duhet të specifikojë kohën dhe datën përkatëse në mënyrë që të ofrojë dëshmi për afatet kohore dhe prioritetin e urdhrave. Në rastin e kryerjes së transaksionit koha e ekzekutimit të urdhërit duhet të vendoset automatikisht nga sistemi i tregtimit që përdor shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat.

Neni 11

Trajtimi i incentivave nga palë të treta

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, gjatë ekzekutimit të urdhrave ose vendosjes së urdhrave për ekzekutim në subjekte të tjera, për një fond pensioni privat, nuk duhet të pranojë asnjë incentivë që është e lidhur me instrumentet financiare.
2. Gjatë ekzekutimit të urdhrave, ose vendosjes së urdhrave për ekzekutim në subjekte të tjera, që kanë të bëjnë me instrumentet financiare për një fond pensioni privat, shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat nuk pranon dhe nuk ngarkon asnjë tarifë, komision ose përfitim monetar ose përfitim jo-monetar kur ato paguhen ose ofrohen nga ndonjë palë e tretë ose një person që vepron në emër të një pale të tretë.

Neni 12

Përfitimet e pranueshme

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat nuk duhet të pranojë përfitim jo monetar, me përjashtim të rastit kur është një përfitim i vogël jo-monetar i cili është i arsyeshëm, proporcional dhe i një shkalle që nuk ka mundësi të ndikojë në sjelljen e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat në mënyrë që të rezultojë në dëmin

e interesave të fondit të pensionit privat, dhe që konsiston në sa më poshtë:

- a) Informacion ose dokumentacion në lidhje me një instrument financiar që është i përgjithshëm në natyrë;
- b) Materiale të shkruara nga një palë e tretë e porositur dhe e paguar nga emetuesi aktual ose potencial i një shoqërie tregtare për të promovuar një emetim kësaj shoqërie, kur pala e tretë është e angazhuar kontraktualisht dhe e paguar nga emetuesi;
- c) Pjesëmarrje në konferenca, seminare dhe trajnime të tjera në lidhje me përfitimet e një instrumenti financiar specifik;
- d) Shpenzime pritje përcjellje në një vlerë minimale të arsyeshme, të tilla si ushqimi dhe pijet gjatë një takimi biznesi ose ndonjë trajnimi tjetër;
- e) Kërkime që kanë të bëjnë me emetimin e titujve nga një emetues, në dispozicion të investitorëve të ardhshëm të këtij emetimi, të përgatitura nga një person që ofron nënshkrimin ose shërbime të porosisë për emetuesin për atë emetim;
- f) Përfitimi i vogël jo-monetar i pranueshëm i përbërë nga informacioni ose dokumentacioni që lidhet me një instrument financiar që është i përgjithshëm në natyrë i përcaktuar në shkronjën a), të pikës 1 të këtij neni, mund të përfshijë materialin e ofruar nga një palë e tretë, që është një shpjegues afatshkurtër i tregut mbi statistikën e fundit ekonomike, rezultatet e shoqërisë tregtare ose informacion mbi të rejtat ose ngjarjet e ardhshme.

SEKSIONI 2

KONFLIKTET E INTERESIT SI PENGESË PËR EKZEKUTIMIN MË TË MIRË

Neni 13

Kriteret për identifikimin e konfliktit të interesit

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, me qëllim identifikimin e llojeve të konfliktit të interesit që lindin gjatë ofrimit të shërbimeve dhe veprimtarive, ekzistenca e të cilave mund të dëmtojë interesat e fondit të pensionit privat, merr në konsideratë, çështjen nëse shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ose një person që është person i lidhur fizik ose juridik i shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat, ndodhet në një nga situatat e mëposhtme, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së administrimit të fondeve por jo vetëm:
 - a) Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ose personi fizik/juridik i lidhur ka të ngjarë të ketë një përfitim financiar, ose të shmangë një humbje financiare, në dëm fondit të pensionit privat;
 - b) Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ose personi fizik/juridik i lidhur

- ka interes në rezultatin e një shërbimi ose të një aktiviteti që i ofrohet fondit të pensionit privat, ose një klienti tjetër, ose në rezultatin e një transaksioni të kryer në emër të fondit të pensionit privat ose një klient tjetër, i cili dallon dhe është i ndryshëm nga interesi i fondit të pensionit privat;
- c) Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ose personi fizik/juridik i lidhur ka incentiva financiare ose incentiva të tjera për të favorizuar interesin e një klienti ose grupi klientësh të tjerë, të ndryshme nga interesat e fondit të pensionit privat;
 - d) Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ose personi fizik/juridik i lidhur kryen të njëjtat aktivitete si për fondin e pensionit privat ashtu dhe për një ose disa klientë të tjerë që nuk është fondi i pensionit privat;
 - e) Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat ose personi fizik/juridik i lidhur merr ose do të marrë nga një person tjetër i ndryshëm nga fondi i pensionit privat, përfitime në lidhje me aktivitetet e administrimit të portofolit kolektiv që i ofrohen fondit të pensionit privat, në formën e parave, mallrave ose shërbimeve, të ndryshme nga komisioni ose tarifa standarde e atij shërbimi.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, në identifikimin e llojeve të konfliktit të interesave, merr parasysh sa më poshtë:
- a) Interesat e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat, duke përfshirë ato që rrjedhin nga përgjegjësia e saj në një grup ose nga kryerja e shërbimeve dhe aktiviteteve, interesat e anëtarëve dhe detyrat e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat ndaj fondit të pensionit privat;
 - b) Interesat e ndryshme të dy ose më shumë fondeve të pensionit privat nën administrimin e saj.

Neni 14

Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat që është pjesë e një grupi financiar

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të hartojë procedura dhe të marrë masa në përputhje me këtë nen, në mënyrë që të sigurohet që personat përgjegjës të angazhuar në aktivitete të ndryshme të veprimtarisë që kanë një konflikt interesi, t'i kryejnë ato aktivitete në një nivel pavarësie të përshtatshëm me madhësinë dhe aktivitetet e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe të grupit financiar të cilit i përket dhe me materialitetin e rrezikut të dëmtimit të interesave të klientëve.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, për të siguruar shkallën e kërkuar të pavarësisë, përfshin aty ku është e nevojshme dhe e përshtatshme procedurat që duhet të ndiqen dhe masat që duhet të merren, si më poshtë:

- a) Procedura efektive për të parandaluar ose kontrolluar shkëmbimin e informacionit ndërmjet personave përgjegjës të angazhuar në aktivitete të administrimit të portofolit që përfshin rrezikun e konfliktit të interesit, kur shkëmbimi i këtij informacioni mund të dëmtojë interesat e një ose më shumë anëtarëve të fondit të pensionit privat nën administrim;
 - b) Mbikëqyrje e veçantë e personave përgjegjës, funksionet kryesore të të cilëve përfshijnë kryerjen e veprimtarive të administrimit të portofolit, ose ofrimin e shërbimeve për fondin e pensionit privat ose anëtarëve, interesat e të cilëve mund të bien ndesh ose përfaqësojnë interesa të ndryshme që mund të krijojnë konflikt, përfshirë këtu ato të shoqërisë administruese;
 - c) Eliminimi në rastet kur ka konflikt interesi i çdo lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërblimit të personave përgjegjës të angazhuar në një aktivitet dhe shpërblimit ose të ardhurave të gjeneruara nga persona të tjerë përgjegjës të angazhuar në një aktivitet tjetër;
 - d) Masa për të parandaluar ose kufizuar çdo person që të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi mënyrën se si një person përgjegjës kryen aktivitete të administrimit të portofolit;
 - e) Masa për të parandaluar ose kontrolluar përfshirjen njëkohësisht ose të njëpasnjëshme të një personi përgjegjës në aktivitete të veçanta të administrimit të portofolit, ku përfshirja mund të pengojë manaxhimin e duhur të konflikteve të interesit.
3. Nëse miratimi ose përdorimi i një ose më shumë prej këtyre masave dhe procedurave nuk garanton nivelin e duhur të pavarësisë, Autoriteti i kërkon shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat të miratojë masa dhe procedura të tjera alternative ose shtesë që janë të nevojshme dhe të përshtatshme për këto qëllime.
4. Dokumenti i politikës dhe procedurave të konfliktit të interesit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat rishikohet dhe përditësohet rregullisht.

Neni 15

Monitorimi i politikave të ekzekutimit të urdhrave

Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat monitoron efektivitetin e marrëveshjeve të ekzekutimit të urdhrave dhe politikën e ekzekutimit me qëllim që të identifikojë dhe, kur është e përshtatshme, të korrigjojë ndonjë mangësi. Në veçanti, duhet të vlerësojë në baza të rregullta nëse platformat e ekzekutimit të përfshira në politikën e ekzekutimit të urdhrave sigurojnë rezultatin më të mirë të mundshëm për fondin e pensionit privat.

Neni 16
Konfliktet e interesit dhe transaksionet personale

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, në rastin e personit përgjegjës që është i përfshirë në aktivitete që mund të shkaktojnë konflikt interesi, ose që ka akses në informacionin e brendshëm ose informacione të tjera konfidenciale në lidhje me fondin e pensionit privat ose në transaksionet për një fond pensioni privat në bazë të një veprimtarie të kryer prej këtij personi në emër të shoqërisë administruese të fondeve, duhet të krijojë, zbatojë dhe marrë masa të përshtatshme që synojnë parandalimin e aktiviteteve si më poshtë:
 - a) Hyrja në një transaksion personal i cili përmbush të paktën një nga kriteret e mëposhtme:
 - i. Ky person ndalohej të kryejë këtë transaksion personal;
 - ii. Transaksioni përfshin keqpërdorimin ose informimin jo të duhur të informacionit konfidencial;
 - iii. Transaksioni bie ndesh me një detyrim të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat sipas ligjit ose rregulloreve të tij;
 - iv. Këshillimi ose sigurimi, përveçse kur parashikohet në kushtet e kontratës së punës apo shërbimit, i çdo personi tjetër që të kryejë transaksion me instrumente financiare të cilat, në rast të transaksionit personal të personit përgjegjës, mbulohen nga shkronja i) e kësaj pike, ose të cilat përbëjnë një keqpërdorim të informacionit në lidhje me urdhrat në pritje;
 - v. Dhënia, përveçse në rrjedhën normale të punësimit ose kontratës së shërbimit, të çdo informacioni ose mendimi një personi tjetër, nëse personi përgjegjës e di ose në mënyrë të arsyeshme duhet të dijë, se si rezultat i dhënies së këtij informacioni, personi tjetër do të kishte mundësi për të marrë një nga hapat e mëposhtëm:
 - a. Të kryejë transaksion me instrumente financiare të cilat, në rast të transaksionit personal të personit përgjegjës, mbulohet nga shkronja i) e kësaj pike, ose të cilat përbëjnë një keqpërdorim të informacionit në lidhje me urdhrat në pritje;
 - b. Të këshillojë ose të shtyjë një person tjetër për të kryer këtë transaksion.
2. Masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni në veçanti hartohen për të siguruar që:
 - a) Çdo person përgjegjës i mbuluar nga pika 1 i këtij neni është i vetëdijshëm për

- kufizimet në transaksionet personale dhe masat e vendosura nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat në lidhje me transaksionet personale dhe dhënien e informacionit, në përputhje me pikën 1 të këtij neni;
- b) Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat informohet menjëherë për çdo transaksion personal të lidhur nga një person përgjegjës, ose nëpërmjet njoftimit të këtij transaksioni ose nëpërmjet procedurave të tjera që i mundësojnë shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat të identifikojnë këto transaksione;
 - c) Mbahen të dhëna për transaksionet personale të njoftuara ose identifikuara nga shoqëria administruese e fondeve, duke përfshirë çdo autorizim ose ndalim në lidhje me këtë transaksion.
3. Për qëllimet e pikës 1, shkronjës a) nën ndarjes ii) të këtij neni, nëse aktivitete të caktuara kryhen nga palë të treta, shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat garanton që subjekti që kryen aktivitetin mban një regjistër të transaksioneve personale të lidhura nga çdo person përgjegjës dhe ja mundëson informacionin shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat menjëherë pas kërkesës.

Neni 17

Përgjashtimi i llojeve të caktuara të transaksioneve personale

Pikat 1 dhe 2 të nenit 16 të kësaj rregulloreje nuk zbatohen për transaksionet personale të kryera në kuadër të një shërbimi të administrimit të portofolit në mënyrë diskrecionale, nëse nuk ka komunikim paraprak në lidhje me transaksionin midis administruesit të portofolit dhe klientit ose personit tjetër për llogari të të cilit ekzekutohet transaksioni.

Neni 18

Regjistrimi i transaksioneve

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të sigurohet, që për çdo transaksion të portofolit që lidhet me fondin e pensionit privat, të regjistrohen pa vonesë informacione që janë të mjaftueshme për të rindërtuar detajet e urdhrit dhe transaksionit të ekzekutuar.
2. Informacioni i referuar në pikën 1 të këtij neni përfshin:
 - a) Emrin e fondit të pensionit privat dhe të personit që vepron për llogari të këtij fondi;
 - b) Detajet e nevojshme për të identifikuar instrumentin në fjalë;
 - c) Sasinë;
 - d) Llojin e urdhrit ose transaksionit;
 - e) Çmimin;

- f) Për urdhrat, datën dhe orën e saktë të dërgimit të urdhrit dhe emrin ose emërtimin tjetër të personit të cilit i është dërguar urdhri ose për transaksionet, datën dhe kohën e saktë të vendimit për të trajtuar dhe ekzekutuar transaksionin;
- g) Emrin e personit që dërgon urdhrin ose që ekzekuton transaksionin;
- h) Aty ku është e aplikueshme, arsyet për revokimin e urdhrit;
- i) Për transaksionet e ekzekutuara, palën tjetër dhe identifikimin e vendit të ekzekutimit.

SEKSIONI 3

TRANSAKSIONET QË PËRFSHIJNË SUBJEKTE TË LIDHURA, PERSONA FIZIKË TË LIDHUR DHE ATA ME LIDHJE PRONËSIE

Neni 19

Transaksionet që përfshijnë subjekte të lidhura, persona fizikë të lidhur dhe ata me lidhje pronësie

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, lidhur me çdo fond pensioni privat që administron, nuk kryen asnjë transaksion me persona me të cilët ka lidhje pronësie ose me të cilët është subjekt i lidhur që rezulton në përfitime të padeklaruara për secilën nga të dyja palët ose kur përfitimet, që rrjedhin nga transaksioni nuk do të kishin lindur nëse transaksioni do të ishte kryer me kushte normale tregu në momentin e transaksionit.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohet se transaksioni ka rezultuar në përfitime të padeklaruara për secilën palë nëse ai nuk është kryer sipas parimit ‘arms length’.
3. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat mund të kryejë transaksione me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar të shoqërisë kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Transaksioni ka si objekt investimet e likuiditeteve të fondit të pensionit privat e të kryera në një bursë ose treg të organizuar me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut sipas parimit “arms length” dhe palët e përfshira në transaksion të mos kenë rënë dakord në lidhje me çmimin përpara marrjes së vendimit për të kryer transaksionin;
 - b) Transaksionet që kanë si objekt shitjen e titujve të fondit të pensionit privat, të kryera në një bursë apo treg të organizuar ose në një treg të rregulluar, me kushtin që çmimi i transaksionit të jetë brenda kushteve të tregut sipas parimit “arms length” dhe palët e përfshira në transaksion të mos kenë rënë dakord në lidhje me çmimin përpara marrjes së vendimit për të kryer transaksionin;
 - c) Transaksionet e titujve në një treg të rregulluar, me kushtin që çmimi i transaksionit të

jetë brenda kushteve të tregut, sipas parimit “arms length” dhe në interesin më të mirë të anëtarëve. Transaksioni duhet të kryhet nëpërmjet platformave “Reuters” ose “Bloomberg” ose mjeteve të tjera të komunikimit; dhe

- i. Transaksioni kryhet me një broker/dealer ndërkombëtar, i cili kuoton rregullisht në atë instrument, me çmime të ekzekutueshme;
 - ii. Transaksioni kryhet me një broker/dealer lokal, i cili kuoton rregullisht në atë instrument, me çmime të shfaqura rregullisht në faqen e tij të kuotimit dhe të ekzekutueshme.
- d) Transaksionet të cilat nuk përfshihen tek shkronja “c”, e pikës 3, të këtij neni dhe të cilat deklarohen nga shoqëria administruese se janë kryer sipas parimit “arms length”, të mbështetur me dokumentacion.
- e) Transaksionet të cilat kanë si objekt titujt ose instrumentat e tregut të parasë të emetuara dhe/ose garantuara nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore të Republikës së Shqipërisë të blera drejtpërdrejt në ankandin primar sipas kushteve më të mira të tregut.
- f) Të gjitha transaksionet të cilat kanë si objekt titujt që emetohen për herë të parë me ofertë fillestare, të kryera sipas kushteve më të mira të tregut.
4. Transaksionet që përfshihen në shkronjën “e” dhe shkronjën “f” të pikës 3, të këtij neni konsiderohen “arms length”.
5. Depozitari shqyrton dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Shoqëritë Administruese sipas Shtojcës 1, dhe njofton në Autoritet nëse nuk është zbatuar parimi “arms length”.
6. Shoqëria administruese gjatë administrimit të aktiveve të fondit të pensionit nuk mund të kryejë transaksione në emër të saj dhe për llogari të fondit, me anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë.
7. Shoqëria administruese nuk duhet të investojë aktivet e fondit të pensionit në tituj ose instrumente të tregut të parasë të emetuara nga:
- i. shoqëria administruese ose çdo aksionar i shoqërisë administruese;
 - ii. sponsori në një fond me pjesëmarrje të mbyllur nëse nuk përmbush kërkesat e parimit të diversifikimit të portofolit;
 - iii. depozitari i fondit të pensionit;
 - iv. çdo person, palë e lidhur me entitetet e radhitura në nënndarjet “i”, “ii” dhe “iii” të kësaj pike.
8. Nëse shoqëria administruese kryen transaksione në emër të fondit dhe pala tjetër është:
- a) aksionari i shoqërisë administruese;
 - b) sponsori në një fond me pjesëmarrje të mbyllur; ose

c) çdo person tjetër që është palë e lidhur me personat juridikë ose individët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, shoqëria administruese është e detyruar të mbajë evidencë dhe t’ia paraqesë Autoritetit në raportimin financiar të asaj periudhe.

Neni 20

Regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave

Të gjitha komunikimet me brokerat duhet të jenë të regjistruara. Shoqëria administruese është e detyruar të mbajë të dhëna dhe dokumentacion për transaksionet me palët e lidhura deri në 7 (shtatë) vjet pas kryerjes së transaksionit. Autoriteti ka të drejtën për të kërkuar në çdo kohë të gjitha të dhënat, regjistrimet e telefonatave dhe komunikimeve, printime të kuotimeve në momentin që është kryer transaksioni, për të verifikuar përputhshmërinë me këtë rregullore.

KREU III

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME MBI INVESTIMET DHE HUAMARRJEN E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT

SEKSIONI 1

INVESTIMET DHE HUAMARRJA

Neni 21

Dispozita të përgjithshme mbi investimet dhe huamarrjen

1. Fondi i pensionit privat investon dhe merr hua sipas dispozitave të përcaktuara në Kreun V të Ligjit dhe në përputhje me këtë rregullore.
2. Investimet në instrumente financiare derivative përdoren vetëm për rastet e mbrojtjes nga rreziku i investimit.
3. Në rast se shoqëria administruese vendos të përdorë derivativë, nuk duhet të ndryshojë objektivat e investimit të fondit të pensionit privat të përcaktuara në prospektin e fondit.
4. Në rast se shoqëria administruese vendos të përdorë derivative, duhet të ketë politikë ose procedurë të brendshme, të cilat përcaktojnë kufizime në lidhje me rreziqet që shoqërojnë përdorimin e tyre.
5. Gjatë administrimit të aktiveve të fondit, shoqëria administruese është e detyruar të respektojë të gjitha dispozitat e parashikuara në Ligj, në këtë rregullore në zbatim të tij si

dhe në prospektin e fondit të pensionit privat, që kanë të bëjnë me administrimin e aktiveve të fondit të pensionit privat.

Neni 22

Tregjet e rregulluara

1. Tregu i rregulluar, i cili duhet të ketë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:
 - a) Është treg i autorizuar nga autoritetet kompetente në vendin në të cilin vepron;
 - b) Ka rregulla në lidhje me listimin dhe tregtimin e titujve;
 - c) Vepron rregullisht në ditët e përcaktuara dhe të publikuara brenda orarit të deklaruar;
 - ç) Ka rregulla për njoftimin në kohë të vëllimeve dhe çmimeve të tregtimit;
 - d) Klerimi dhe shlyerja kryhet në strukturat përkatëse;
 - dh) Regjistrimi i pronësisë dhe transferimi i pronësisë kryhet nga strukturat e depozitarit, nën kujdestarit dhe regjistrarit qendror.
2. Fondi i pensionit privat nuk investon në tituj të transferueshëm nëse këto nuk janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar sipas pikës 1 të këtij neni, me përjashtim të rasteve që ka parashikuar ligji dhe kjo rregullore.
3. Tregu mbi banak (OTC) i titujve të Qeverisë Shqiptare konsiderohet treg i rregulluar në kuptim të këtij neni.

Neni 23

Indekset Financiare

1. Kërkesat e këtij neni zbatohen për fondet e pensionit të cilat investojnë në:
 - a) Derivatvët që bazohen në indekset financiare;
 - b) SIK me ofertë publike që ndjekin një indeks.
2. Indekset financiare duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Indeksi është mjaftueshëmrisht i diversifikuar;
 - b) Indeksi përfaqëson një pikë referimi të përshtatshme për tregun në të cilin ai i referohet; dhe
 - c) Indeksi publikohet në mënyrë të përshtatshme.
3. Indekset financiare të listuara në shtojcën 2 të kësaj rregullore konsiderohen mjaftueshëmrisht të diversifikuara.

4. Indeksi financiar përfaqëson një pikë referimi të përshtatshme për tregun në të cilin ai i referohet nëse:
 - a) Mat performancën e një grupi përfaqësues titujsh bazë në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme;
 - b) Rishikohet ose ribalancohet në mënyrë periodike për të siguruar se vazhdon të pasqyrojë tregjet të cilat ajo i referohet, duke ndjekur kriteret të cilat i janë vënë në dispozicion të publikut; dhe
 - c) Titujt bazë janë mjaft likuide, duke i lejuar përdoruesit përsëritjen nëse është e nevojshme.

5. Indeksi publikohet në mënyrë të përshtatshme nëse:
 - a) Procesi i publikimit mbështetet në procedura të shëndosha për mbledhjen e çmimeve, dhe përlllogarit dhe më pas publikon vlerën e indeksit, duke përfshirë procedurat e çmimeve për komponentët ku nuk ka një çmim tregu; dhe
 - b) Informacioni thelbësor mbi çështje të tilla si llogaritja e indeksit, metodologjia e ribalancimit, ndryshimet e indeksit ose ndonjë vështirësi operationale në sigurimin e informacionit në kohë dhe të saktë ofrohet gjerësisht dhe në kohë.

SEKSIONI 2 PËRDORIMI I DERIVATIVËVE

Neni 24

Përdorimi i derivativëve për menaxhimin efikas të portofolit

1. Fondi i pensionit privat mund të përdorë derivativë në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregullore. Fondi i pensionit privat:
 - a) Lejohet të përdorë teknika dhe instrumente në lidhje me monedhat, titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë sipas kushteve dhe brenda kufijve të përcaktuar në Ligj dhe në këtë rregullore. Në asnjë rrethanë, këto veprime nuk duhet të shkaktojnë ndryshim të objektivave të fondit të pensionit privat siç përcaktohet në prospektin e fondit të pensionit dhe deklaratën e investimit;
 - b) Garanton që ekspozimi i fondit të pensioni në total në lidhje me instrumentet derivativë nuk e tejkalon vlerën totale neto të portofolit të tij. Ekspozimi llogaritet duke marrë parasysh vlerën aktuale të aktiveve bazë, rrezikun e palës tjetër, lëvizjet e ardhshme të tregut dhe kohën në dispozicion për të likuiduar pozicionet;

- c) Mund të investojë, si pjesë e politikës së tij të investimeve dhe brenda kufijve të përcaktuar në këtë rregullore, në instrumentet derivativë, me kusht që ekspozimi ndaj aktiveve bazë të mos kalojë në tërësi kufijtë e investimeve të përcaktuara në këtë rregullore. Kur fondi i pensionit privat investon në instrumente derivativë të bazuar në indeks, këto investime nuk mblidhen në llogaritjen që bëhet për respektimin e kufijve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kur titulli i transferueshëm ose instrumenti i tregut të parasë ka të bashkëngjitur (embeds) një instrument derivativ, atëherë instrumenti derivativ do të merret parasysht nëse përmbush kërkesat e pikës 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Transaksionet e lejuara në derivativë

1. Transaksionet duhet të bëhen në ato derivativë që tregtohen në një treg të rregulluar të derivativëve.
2. Aktivi bazë i transaksionit në derivativë konsiston në një ose më shumë nga instrumentet e mëposhtme të lejuar sipas Ligjit, kësaj rregulloreje dhe prospektit të fondit të pensionit privat:
 - a) Tituj të transferueshëm;
 - b) Instrumentet e tregut të parasë;
 - c) Depozitat;
 - ç) Derivatvët e lejuar sipas këtij Seksioni;
 - d) Aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
 - dh) Indekset financiare që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 23 të kësaj rregulloreje;
 - e) Normat e interesit;
 - ë) Kurset e këmbimit valutor; dhe
 - f) Monedhat.
3. Transaksioni në derivativë nuk ndërmerret nëse sipas kushteve të përcaktuar në nenin 26, pika 1 e kësaj rregulloreje, ka një shitje të zbuluar të një ose më shumë titujve të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë, aksione ose kuota në sipërmarrjet e investimeve kolektive ose derivativë.
4. Transaksioni me derivativë duhet të kryhet me palë të pranueshme.

5. Për qëllimet e pikës 4 të këtij neni, palë e pranueshme janë klientët profesionistë të përcaktuar në Ligjin “Për Tregjet e Kapitalit”.
6. Derivativi është instrumenti që plotëson kriteret e mëposhtme:
 - a) Lejon transferimin e rrezikut të kreditit të aktivit bazë në mënyrë të pavarur nga rreziqet e tjera që lidhen me atë aktiv bazë;
 - b) Nuk rezulton në dhënien ose transferimin e aktiveve të ndryshme nga ato të referuara në nenin 90 të Ligjit ose siç lejohet nga dispozitat e këtij Kreu duke përfshirë mjetet monetare;
 - c) Rreziqet e tij identifikohen në mënyrë të përshtatshme gjatë procesit të administrimit të rrezikut të shoqërisë administruese të fondeve dhe nga mekanizmat e saj të kontrollit të brendshëm. Këtu përfshihen rreziqet e asimetrisë së informacionit midis shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe kundërpalës në lidhje me derivativët. Këto rreziqe vijnë nga akseset që mund të ketë kundërpala në informacionin jo-publik mbi subjektet, aktivet e të cilëve janë përdorur si aktiv bazë i atij derivativi.

Neni 26

Kufizimet në përdorimin e derivativëve

1. Transaksioni në derivativë nuk duhet të kryhet për një fond të pensionit privat përveç nëse:
 - a) Transaksioni është i llojit të specifikuar në këtë rregullore;
 - b) Transaksioni mbulohet nga aktivet ose mjetet monetare; dhe
 - c) Asnjë element i mbulimit nuk përdoret më shumë se një herë.
2. Kur një fond i pensionit privat investon në derivativë, ekspozimi ndaj aktiveve bazë nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nenit 91 të Ligjit, përveç rasteve të parashikuara në pikën 4 të këtij neni të kësaj rregullore.
3. Kur titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë i bashkëngjitet një derivativ, atëherë ky nuk do të merret në konsideratë në llogaritjen e kufijve të investimit sipas nenit 91.
4. Titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë i bashkëngjitet një derivativ nëse ai përmban një element përbërës i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) Në sajë të këtij përbërësi, disa ose të gjitha flukset e mjeteve monetare që në të kundërt do t'i kërkoheshin titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë që funksionon si kontratë bazë mund të modifikohen sipas një norme interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, kursit të këmbimit, indeksit të çmimeve ose të normave, klasifikimit të kreditit ose të indeksit të kreditit ose të një variable tjetër, dhe prandaj ndryshojnë në një mënyrë të ngjashme me një derivativ më vete;
 - b) Karakteristikat dhe rreziqet e tij ekonomike nuk janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë;
 - c) Ka një ndikim të rëndësishëm në profilin e rrezikut dhe çmimin e instrumentit të transferueshëm ose të tregut të parasë.
5. Titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë nuk i bashkëngjitet një derivativ kur ai përmban një element i cili është i transferueshëm në kontratë në mënyrë të pavarur nga titulli i transferueshëm ose instrumenti i tregut të parasë. Ky element konsiderohet të jetë një instrument i veçantë.
 6. Kur fondi i pensionit privat investon në një instrument derivativ të bazuar në indeks, me kusht që indeksi përkatës të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 23 të kësaj rregulloreje, titujt bazë të indeksit nuk duhet të merren parasysh kur llogaritet pajtueshmëria me nenin 91 të Ligjit.

KREU IV

KUFIJTË E INVESTIMEVE DHE HUAMARRJES TË ZBATUESHME PËR FONDET E PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR DHE TË MBYLLUR

SEKSIONI 1

DISPOZITA NË LIDHJE ME KUFIJTË E INVESTIMEVE DHE HUAMARRJES

Neni 27

Dispozita të përgjithshme

1. Investimet e fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur përbëhen nga një ose më shumë aktive të lejuara sipas nenit 90 të Ligjit.
2. Huamarrja e fondit të pensionit privat duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe të kësaj Rregullore.
3. Administrimi i likuiditetit të fondit të pensioni privat duhet të jetë në përputhje me

dispozitat e Ligjit dhe të kësaj Rregullore.

4. Fondet e pensionit privat duhet të respektojnë kufijtë e ekspozimeve të përcaktuara në nenin 91 të Ligjit.

Neni 28

Huamarrja për fondet e pensionit privat

1. Shoqëria administruese mund të përdorë teknika dhe instrumente që lidhen me titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, nëse këto teknika dhe instrumente përdoren për qëllime të menaxhimit efikas të portofolit të fondit.
2. Fondet e pensionit privat, mund të marrin hua me kusht që huamarrja të bëhet në baza të përkohshme, jo më shumë se 90 ditë, dhe nuk përbën më shumë se 5% të vlerës neto të aktiveve të fondit.
3. Shoqëria administruese raporton në Autoritet vlerën e marrë hua për llogari të fondit të pensionit të detajuar sipas institucioneve financiare huadhënëse. Raportimi i huamarrjes bëhet për vitin ushtrimor dhe për periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor sipas afateve të parashikuara të depozitimit të pasqyrave financiare në Autoritet në Rregulloren “Mbi formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”.

Neni 29

Huadhënia për fondet e pensionit privat

Fondi i pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur nuk jep hua përveçse përmes investimit në obligacione ose instrumente të tregut të parasë ose përmes vendosjes së depozitave. Dhënia e huave dhe/ose veprimi si dorëzanës në emër të palëve të treta nga ana e fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur nuk lejohet as nga fondi i pensionit privat dhe as nga shoqëria administruese, ose depozitari që vepron në emër të fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur.

Neni 30

Diversifikimi i portofolit dhe Kufizimet e Investimeve

1. Përveç sa parashikon Ligji, fondet e pensionit privat duhet të respektojnë edhe kufijtë e ekspozimeve të përcaktuara në këtë nen.

2. Një fond pensioni privat, nuk investon më shumë se 5% të vlerës së aktiveve të fondit në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë te një emetues i vetëm, me përjashtim të rastit kur:
 - i. limiti i 5% mund të rritet në 10%, por në këtë rast vlera totale e titujve dhe e instrumenteve të tregut të parasë të mbajtura nga një fond pensioni privat në organet emetuese ku në secilin prej tyre investon më shumë se 5% të aktiveve të tij nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së aktiveve të të fondit të pensionit.
3. Një fondi pensioni nuk investon më shumë se 20% të vlerës së aktiveve të fondit në mjete monetare dhe depozita pranë një subjekti të vetëm bankë të licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe/ose vendet e OECD-së.
4. Ekspozimi i riskut ndaj një kundër pale të fondit të pensionit në një transaksion derivativ në OTC nuk duhet të tejkalojë:
 - 10% të aktiveve të saj kur kundërpala është një bankë; ose
 - 5% të aktiveve të saj, në raste të tjera.
5. Pavarësisht nga kufijtë individualë të përcaktuar në pikën 2, 3 dhe 4 të këtij neni, një fond pensioni nuk do të kombinojë asnjë nga investimet e mëposhtme, nëse kombinimi do të çonte në investimin e më shumë se 20% të aktiveve të tij në një organ të vetëm emetues:
 - a) Investime në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parave të emetuara nga i njëjti organ;
 - b) Depozitat në të njëjtën bankë; ose
 - c) Ekspozimet që rrjedhin nga transaksionet e derivateve OTC të ndërmarra nga ai organ.
6. Për titujt e borxhit të emetuar nga banka ose institucione financiare jobankare, që nuk janë të pranuar për tregtim në tregje të rregulluara, kufiri i investimit në këto tituj është deri në 2% të vlerës së aktiveve të fondit në një emetues të vetëm dhe ekspozimi në total në këto instrumente nuk tejkalon 5% të vlerës së aktiveve të fondit të pensionit.
7. Kompanitë që bëjnë pjesë në të njëjtin grup për qëllime të llogarive të konsoliduara, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat aktuale në përputhje me rregullat/standardet e njohura ndërkombëtare të kontabilitetit, do të konsiderohen si një organ i vetëm për qëllimin e llogaritjes së limiteve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 31

Kriteret për investimin e fondit të pensionit privat në tituj të transferueshëm

Titujt e transferueshëm si instrumente financiare në të cilat fondi i pensionit privat lejohet të investojë janë ato që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Humbja potenciale që mund të pësojë fondi privat i pensionit në lidhje me mbajtjen e këtyre instrumenteve është e kufizuar në shumën e paguar për to;
- b) Informacioni i përshtatshëm është i disponueshëm për titujt e transferueshëm, në formën e informacionit të rregullt, të saktë dhe të plotë mbi sigurinë;
- c) Janë të negociueshme;
- d) Blerja e tyre është në përputhje me parimet, strategjinë dhe objektivat e investimit të fondit të pensionit privat;
- e) Rreziqet e titujve të transferueshëm mbulohen në mënyrë të përshtatshme nga sistemi i menaxhimit të rrezikut të fondit të pensionit privat.

Neni 32

Kriteret për investimin e fondit të pensionit privat në instrumente të tregut të parasë

1. Instrumente të tregut të parave në të cilat fondi i pensionit privat lejohet të investojë janë ato që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Vlera e të cilit mund të përcaktohet saktë në çdo kohë, pra për të cilin janë në dispozicion sisteme dhe metodologji vlerësimi të sakta dhe të besueshme.
 - b) Të lejojë që vlera e aktiveve neto të fondit të llogaritet sipas vlerës në të cilën një instrument financiar i mbajtur në portofolin e fondit mund të jetë subjekt i një transaksioni në treg të përfunduar midis palëve të informuara dhe atyre që nuk kanë lidhje me të, të gatshme për të kryer transaksionin;
2. Të bazohen në të dhënat e tregut apo modelet e vlerësimit, duke përfshirë metodat e bazuara në kostot e amortizuara.

Neni 33

Investimet e ndaluara

Aktivet e fondit të pensionit nuk duhet të investohen në:

- a) metale të çmuara apo të ekspozohen ndaj bursave të mallrave të tjerë;

- b) në aktive fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si: antika, punime arti, mjete motorike, etj.

Neni 34

Deklarata për parimet e investimit

1. Përveç përmbajtjes së parashikuar në nenin 92, të ligjit për fondet e pensionit privat, deklarata për parimet e investimit duhet të përmbajë gjithashtu:
 - a) Të gjitha rreziqet që lidhen me investimet dhe strukturën e aktiveve të fondit dhe detyrimeve të fondit të pensionit privat, me një paraqitje tabelare të këtyre rreziqeve, dhe;
 - b) Ndikimin e këtyre rreziqeve mbi fondin dhe shoqërinë administruese të fondit.
2. Deklarata duhet të vihet në dispozicion të anëtarëve të fondit në mënyrën e përcaktuar në pikën 4, në nenin 92, të ligjit.

SEKSIONI 2

MENAXHIMI I LIKUIDITETIT

Neni 35

Menaxhimi i likuiditetit dhe rrjedhjes së parave

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të ketë një plan të menaxhimit të likuiditetit, të miratuar nga Bordi, për çdo fond pensioni privat që:
 - a) mbulon çdo opsion investimi për fondet e pensionit;
 - b) përshkruan procedurat e përcaktuara nga shoqëria administruese për matjen dhe menaxhimin e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme;
 - c) ruan një nivel të likuiditetit të aktiveve në fondin e pensionit privat, në përputhje me detyrimet themelore të tij, bazuar në vlerësimin relativ të likuiditetit të aktiveve të fondit të pensionit në treg, duke marrë parasysh kohën që nevojitet për shlyerjet dhe çmimin ose vlerën me të cilën këto aktive mund të shlyhen si dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj rreziqeve ose faktorëve të tjerë të tregut;
 - d) përfshin shqyrtimin se si mund të menaxhohet likuiditeti i alternativave/opsioneve të investimit të një fondi pensioni privat në një sërë skenarësh stresi të cilat përfshijnë skenarë ekstremë por të besueshëm të rënies së likuiditetit;

- e) identifikon rrethanat që shoqëria administruese i konsideron si një rezultat i pafavorshëm i likuiditetit dhe që kërkon veprim (ngjarje likuiditeti);
 - f) përshkruan përshkallëzimin e masave të duhura në sistemin dhe procedurat e administrimit të likuiditetit për të trajtuar si duhet mungesën aktuale ose të pritshme të likuiditetit;
 - g) përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e personave të përfshirë në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut të likuiditetit, duke përfshirë rolin e Bordit, komiteteve përkatëse të Bordit dhe drejtuesve të lartë; dhe
 - h) përshkruan informacionin, duke përfshirë matjet kryesore, që duhet t'i raportohen Bordit, komiteteve përkatëse të Bordit dhe drejtuesve të lartë, për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të rrezikut të likuiditetit.
2. Shoqëria administruese duhet të sigurojë që informacioni, duke përfshirë matjet kryesore të përmendura në gërmën h), të pikës 1 të këtij neni, të rishikohen në mënyrë periodike nga Bordi, komitetet përkatëse të Bordit dhe drejtuesit e lartë, për të siguruar që ky informacion dhe matjet kryesore mbeten të përshtatshme.
 3. Shoqëria administruese duhet të rishikojë/shqyrtojë/monitorojë në mënyrë të vazhdueshme likuiditetin e portofolit të fondit të pensionit në atë mënyrë që periodikisht të vlerësojë nëse ka mjaftueshëm instrumente likuide për të përmbushur në çdo kohë kërkesat e likuiditetit që rrjedhin nga përfundimi i anëtarësimit në fond siç parashikohet në ligjin nr.76/2023 “Për fondet e pensionit privat”.
 4. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat duhet të rishikojë të paktën një herë në vit dhe të përditësojë sa herë që ka ndryshime ose krijohen rrethana të reja, politikën e administrimit të rrezikut si dhe planin e manaxhimit të likuiditetit si pjesë e kësaj politike dhe t'i depozitojë pranë Autoritetit, brenda tremujorit të parë të vitit.

Neni 36

Bashkërendimi i strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe shlyerjeve

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat garanton që, për çdo fond pensioni të miratuar me pjesëmarrje të hapur dhe pjesëmarrje të mbyllur që administron, strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes dhe tërheqjes së kuotave të jenë të bashkërenduara me njëra tjetrën. Strategjia e investimit, profili i likuiditetit, politika e shlyerjes dhe tërheqjes së kuotave të secilit fond pensioni privat të administruar nga shoqëria administruese, konsiderohen të bashkërenduara kur anëtarët mund të shlyejnë dhe tërheqin aktivet neto të tyre në përputhje me trajtimin e drejtë të të gjithë anëtarëve të fondeve të pensionit privat dhe në zbatim të politikës së shlyerjes dhe detyrimeve të fondit.

2. Për të vlerësuar bashkërendimin e strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe politikës së shlyerjes dhe tërheqjes së kuotave, shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat mund të mbajë parasysh edhe ndikimin që mund të kenë shlyerjet dhe tërheqjet e kuotave në çmimet bazë ose diapazonet e çmimeve të aktiveve të veçanta të fondit të pensionit privat.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Neni 38
Shfuqizimi

Me miratimin e kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 1, datë 28.01.2010 " Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit", shfuqizohet.

SHTOJCA 1

1. A është kryer transaksioni në bursë/treg të organizuar sipas kushteve të nenit 19, pikës 3/a? Nëse po, duhet konfirmimi i marrëveshjes të kryer në bursë.
2. Është kryer transaksioni në një treg të rregulluar sipas kushteve të nenit 19, pikës 3/b? Nëse po, dokumentacioni duhet të përfshijë:
 - a) Vendim nga shoqëria administruese për qëllimin e kryerjes së transaksionit.
 - b) Në rast të një tregu aktiv, një *screenshot* (p.sh. Bloomberg All quotes për letrën me vlerë e cila është tregtuar, verifikohet nëse çmimi ka qenë brenda “range bid/ask” të tregut, krahasohet dhe me “mid price”).
 - c) Në rast të një tregu të rregulluar por jo aktiv (kontaktet dhe bisedat e dokumentuara me të paktën tre broker/dealer ku është kërkuar ofertë për kryerjen e transaksionit “bid/ask”).
3. A është kryer transaksioni sipas kushteve të nenit 19, pikës 3/c?
 - a) Nëse është kryer me një broker/dealer ndërkombëtar, “*screenshot*” të të gjitha kuotimeve për atë instrument.
 - b) Nëse është kryer me një broker lokal, “*print screen*” të kuotimeve të brokerit në momentin e kryerjes së transaksionit, si dhe bisedat e dokumentuara me brokera të tjerë (krahasohet nëse çmimi ka deviacione nga “bid/ask range mesatar”).
4. A është kryer transaksioni në një treg të rregulluar por që nuk përfshihet në nenin 19, pika 3/c?
 - a) Nëse po, Deklaratën e shoqërisë administruese në lidhje me faktin që transaksioni ka qenë “*Arms Length*”, si dhe bisedat e dokumentuara me të paktën tre broker/dealera ku është marrë ofertë për kryerjen e transaksionit (bidask).
 - b) Në qoftë se nuk ka oferta, duhet argumentim i detajuar nga shoqëria administruese, se përse konsiderohet “*Arms Length*” transaksioni, duke përfshirë kurbën e Yieldit të instrumentit me interpolim, por duke eliminuar pikat e kurbës që kanë diferencë të dukshme me pikat e tjera.
5. A është kryer transaksioni sipas kushteve të nenit 20, pika 3/f? Nëse po, dokumentacion mbështetës që vërteton se emetimi ka qenë për herë të parë.

SHTOJCA 2

Indekset

AEX-Index

Amex

Indeksi CAC 40

CAC Tjera 20

Deutsche Boerse AG German Stock Index DAX- Indeksi i Aksioneve në Gjermani DAX

Dow Jones & Company

EURO STOXX 50

Indeksi i FTSE 100

Indeksi i FTSE MIB

Indeksi FTSE MID 250

Indeksi Hong Kong i Hang Seng

Indeksi IBEX 35

JPX400

Indeksi Lux - Bursa e Luksemburgut

MICEX

MSCI

Nikkei 225

Indeksi OBX

Indeksi OMX Stockholm 30

RTSI

Indekset Russell

SBF 250

Standard & Poor's

S & P / ASX 200

Indeksi i Tregut të Zvicrës

Topix